



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut

Opština Kacanik  
Municipal Kacanik

01Nr. 60/01- 9376/24  
Kaçanik, 23.04.2024

## PROCESVERBAL

Nga mbledhja **IV (katërt)** e Rregullt e Komitetit për Komunitete, mbajtur me datë: 23 Prill 2024 (E Martë). Mbledhja u mbajt në katin e dytë të objektit të administratës Komunale, në sallën e komiteteve të Kuvendit, me fillim pune në ora 13:00. Pjesëmarrës të këtij takimi nga Komiteti për Komunitete ishin: Arta Aydiu-LVV, Ekrem Pjesëmarrës të këtij takimi nga Komiteti për Komunitete ishin: Arta Aydiu-LVV, Ekrem Livoreka-AAK, Betim Shala-LDK, Lejla Muhamheri-Çaka-PDK, Arben Thaqi- OJQ. Nga Ekzekutivi i komunës në takim mori pjesë z. Vedat Dema - Kordinator i NJDNJK.

Mbledhjen e udhëhoqi, kryesuesi i Komitetit për Komunitete, Ekrem Livoreka. Prosesmbajtëse Mavije Murseli. Asistente e Kryesuesit të Kuvendit.

**z.Ekrem Livoreka:** Fillimi përshtendes të pranishmit, konstatoj kuorumin dhe hapi mbledhjen e IV-të (katërt) të rregullt të Komitetit për Komunitete për vitin 2024, data 24 Prill, me këtë :

### REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit për Komunitete;
2. Të drejtat e qytetarëve të komunës së Kaçanikut; dhe
3. Të ndryshme.

Nëse ka diçka rrëth rendit të punës, e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë rendi i punës u shtrua në votim dhe u votua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së Komitetit për Komunitete.

### APROVOJ

Redin e punës, në përbërje prej 3 pikave

U kalua në shqyrtimin e pikave sipas renditjes:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e fundit e Komitetit për Komunitete

**Kryesues i Komitetit Ekrem Livoreka:** A keni ndonjë vërejtje rrëth procesverbalit nga mbledhja e kaluar? Nëse jo atëherë, a jeni për miratimin e këtij procesverbalit? Prosesverbalit i mbledhjes së III (tretë) të Komitetit për Komunitete i vitit 2024, u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi se Komitetit për Komunitete e,

**Aprovoj**  
**Prosesverbalin e mbledhjes se III (tretë) të Komitetit për Komunitete të vitit 2024,**  
të datës 26.03.2024 / Lënda : 01Nr. 60/01-7060/24.

## 2. Të drejtat e qytetarëve të komunës së Kaçanikut;

**z. Vedat Dema:** Qytetarët duhet të kenë të drejtën të japid opiniione, të shprehin pakënaqësi dhe të debatojnë për prioritetet e komunës. Pjesëmarrja e kuptimplotë i fuqizon qytetarët të marrin vendime por edhe t'i pranojnë vendimet e marra nga ata që i përfaqësojnë. Pjesëmarrja e qytetarëve nënkupton bashkëpunim mes institucioneve dhe qytetarëve për një çështje e cila është në interesin e përgjithshëm të qytetarëve, si organë ligjvënëse po ashtu edhe ekzekutive duhet ti mbrojnë interesat e qytetarëve. E drejta për zhvillim të qëndrueshëm është e drejtë e njeriut, prandaj edhe komunat duhet që të sigurojnë standartet më të larta në edukim, shëndet, mbrojtje të ambientit dhe në politika tjera sociale të rëndësishme.

Duke pasur parasysh që këto nuk mund të sigurohen brenda një mandati elektoral, por kërkojnë investime politike dhe ekonomike për vite të tëra, qeveritë lokale janë në presion që të i ndryshojnë politikat në atë mënyrë që të dallohen nga politikat e pasardhësit, mirëpo, asnjëherë në dëm të zhvillimit të qëndrueshëm.

Qeveritë lokale e kanë obligim të ofrojnë shërbime të caktuara, duke përfshirë edukim, shëndetësi, strehim, trajtimin e ujërave të zeza dhe ujë të pijshëm. Është e kuptueshme që disa shërbime nuk arrihen menjëherë, por qeveria lokale duhet të ketë plan për arritjen e tyre. Në të gjitha rrëthanat duhet të ofrojnë një minimum të shërbimit.

Për të vlerësuar se a ofron komuna të drejta ekonomike dhe sociale, janë disa kritere të cilat vlerësojnë arritjen e këtyre obligimeve. Këto kritere pyesin: A ofrohen shërbimet, a ekzistojnë ato dhe a janë të qasshme dhe a mund të arrihen ato?

A ofrohen në atë mënyrë që është e përshtatshme për komunitetin dhe a i plotësojnë nevojat e komunitetit dhe pritet e tyre.

Gjithë përfshirja është ndër parimet kryesore të qeverisjes së mirë, e cila u mundëson të gjithë qytetarëve te marrin pjesë pa marrë parasysh moshën gjininë racën apo fenë pasi të gjithë janë të barabartë, në vendimmarrje.

Pjesëmarrja e grupeve, pa dallim race, gjinie, besimi fetar, në planifikim të qytetit duhet të konsiderohet si e drejtë elementare.

Qeverisja e mirë nuk ka të bëjë me marrjen e vendimeve "korrekte", por për procesin më të mirë të mundshëm për marrjen e këtyre vendimeve. Qeverisja e mirë nuk është e lidhur vetëm me performancën e institucioneve, por edhe kontributin dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin e marrjes dhe zbatimit të vendimeve.

Kompetencat e pushtetit lokal rregullohen me Kushtetutën e Kosovës dhe me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale. Qëllimi i këtij ligji është që të mundësohet ekzistimi i një sistemi të qëndrueshëm të vetëqeverisjes lokale dhe të përmirësimit të efikasitetit të shërbimeve publike.

Fushat që janë kompetencë vetanake e komunave kanë të bëjnë me shërbime dhe nevoja të përditshme të qytetarëve apo shërbime esenciale, në mënyrë që të sigurohet cilësia e duhur e këtyre shërbimeve por edhe që rregullimi i tyre të bëhet sipas specifikave dhe nevojave të qytetarëve të lokacioneve gjeografike të caktuara.

Mënyra më e mirë dhe sigurt për të arritur modele të suksesshme dhe të qëndrueshme për të siguruar pjesëmarrjen e qytetarëve është përmes mekanizmave të strukturuar dhe të institucionalizuar.

Këto mekanizma janë: informimi publik, konsultimi publik, e drejta e peticonit, iniciativat qytetare, referendumi, dhe komitetet konsultative.

**z.Arben Thaqi :** Të drejtat e njeriut janë temë e rëndësishme për çdo shoqëri demokratike dhe zbatimi i këtyre të drejtave mund të jetë sfidues. Në vendimmarrje a ka pasur ndryshime, a është dëgjuar zëri i drejtave të qytetareve për kërkesat që kanë pasur në debate publike, pasi që shpesh ndodh që të drejtat e tyre nuk zbatohen. Ka pas masivitet dhe ka pasur njerëz të interesuar për pjesëmarrje në debate, mirëpo njerëzit janë lodhur me kërkesat e tyre që nuk zbatohen.

Ju si komunë a keni bërë ndonjë analizë për drejtat e qytetareve.

Në fakt është e rëndësishme të analizojmë dhe kuptojmë pse po ndodhin këto sfida, sepse një gjë e tille është shqetësuese sidomos pjesëmarrja e njerëzve siç me thënë është një lloj zhgënjimi që kanë, prandaj mendoj që këtu duhet behet një analizë me kuptua pse kjo është te vendimmarrja, sa janë kanë ato qytetarë me kërkesat e tyre legjitime që me i marrë për bazë si komunitetit ose si organizatë joqeveritare.

**znj.Arta Avdiu:** Ndoshta qytetaret janë të zhgënjer përderisa nuk marrin pjesë në debatet publike!

**z.Vedat Dema :** Sa i përket zhgënjimit dhe analizës , për analizë nuk jam aq i sigurt nuk e kam atë informacion, sepse është zyrtarja për informim ajo që merret me këto çështje, janë edhe anëtarët e kuvendit për këto çështje ku diskutohen për hartimin planifikimin buxhetit , gjithashtu edhe tek ndarja e buxhetit janë po këto anëtarë të kuvendit , një gjë duhet me pas parasysh sepse qytetaret janë ato që i zgjedhin anëtarët e kuvendit sepse këto i përfaqësojnë interesat e qytetareve.

**z.Arben Thaqi :** Unë jam përfaqësuesi i vetëm i OJQ-së ndërsa këta të gjithë janë të partive politike, ndoshta nga njëherë janë të njëanshëm ndoshta kanë kritika pa bazë, por unë kam qenë pjesë e disa debateve që janë mbajt kryesisht për sport rini dhe arsim dhe që aktivitet i kam zhvillu me ato, por nga njëherë nuk janë përfill kërkesat e tonë, debatet publike janë shumë të rëndësishme për atë thirren.

**z.Vedat Dema :** Problemi është qe ne e dimë qe dhe komunat kanë buxhet, por buxheti i tyre nuk ka kapacitet ti përfshij të gjitha kërkesat e qytetareve dhe organizatave. Por çështja e pjesëmarrjes nëpër debate publike nuk është vetëm në komunën e Kaçanikut është edhe komuna tjera.

**z.Ekrem Livoreka:** Ky problem nuk është veç në komunën e Kaçanikut por në të gjithë komunat e Kosovës, sepse me DEMOSIN e kemi zhvilluar një punëtori në restorant Liburna, ku vetë edhe ata e shprehen këtë shqetësim për mos pjesëmarrje në debate publike në gjitha komunat e Kosovës. Pjesëmarrja është shumë e dobët edhe ne si anëtarë të kuvendit nuk marrim pjesë nëpër debate publike .

**3.Të ndryshme:**

**Kryesues i Komitetit Ekrem Livoreka:** A keni diçka për të diskutuar në pikën të ndryshme ? Nëse jo, atëherë e shpalli mbledhjen të përfunduar, në ora 14:00.

Procesmbajtësja  
Mavije Murseli



Kryesues i Komitetit për Komunitete  
Ekrem Livoreka